



---

**RREGULLORE NR. 2002/10**

**MBI THEMELIMIN E KËSHILLIT EKONOMIK DHE FISKAL**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të datës 25 korrik të vitit 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autoritetin e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë,

Duke marrë parasysh gjithashtu Rregulloren nr. 2001/9 të UNMIK-ut të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë si dhe Rregulloren e ndryshuar nr. 2001/19 të UNMIK-ut të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë e cila i referohet Këshillit ekonomik dhe fiskal,

Me qëllim të themelimit të Këshillit ekonomik dhe fiskal,

Me këtë rast shpall sa vijon:

Neni 1

1.1 Me anë të kësaj Rregulloreje themelohet Këshilli ekonomik dhe fiskal (në tekstin e mëtejshëm “Këshilli”) si organ këshilldhënës i PSSP-së. Përbërja e Këshillit është ashtu siç është paraqitur në shtojcën e kësaj Rregulloreje.

1.2 Këshilli jep këshilla përkitazi me çështjet ekonomike, financiare ose fiskale për të cilat kërkohet konsultim me Këshillin dhe me Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (në tekstin e mëtejshëm “IPVQ”), duke përfshirë këshillat vijuese:

- (a) Caktimin e parametrave financiarë dhe të politikës së punës për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe për miratimin e tij.
- (b) Rregullativën e ndërmarrjeve publike dhe shoqërore dhe
- (c) Çështjet e tjera ekonomike, financiare ose fiskale që PSSP-ja mund t'ia përcjellë Këshillit me iniciativën e tij ose me kërkesën e anëtarëve të tjerë të Këshillit.

1.3 PSSP-ja, e në mungesë të tij përfaqësuesi i tij i caktuar, e kryeson Këshillin dhe i thërret mbledhjet e Këshillit.

1.4 PSSP-ja, sipas gjykimit të tij apo në pajtim me propozimin e Këshillit ose të një a më shumë anëtarëve të tij, mund t'i ftojë zyrtarët e UNMIK-ut dhe të IPVQ-së, si dhe ekspertët për të marrë pjesë mbi baza të përkohshme në punën e Këshillit lidhur me shqyrtimin e një a më shumë çështjesh të caktuara.

1.5 Funkcionet këshilldhënëse të Këshillit nuk i cenojnë të drejtat dhe kompetencat e PSSP-së të parapara me Rezolutën 1244(1999).

## Neni 2 Dispozitat e përgjithshme

2.1 PSSP-ja e miraton rendin e ditës për çdo mbledhje të Këshillit.

2.2 Shërbimet ndihmëse të sekretarisë (“në tekstin e mëtejme “Sekretaria”) i kryen personeli i Shtyllës IV të UNMIK-ut (Rindërtimi ekonomik) i caktuar për këtë qëllim nga Zëvendësi i PSSP-së për Rindërtim Ekonomik. Sekretaria, veç tjerash, kryen këto detyra:

- (a) Pranon, përpunon dhe i paraqet Këshillit dokumente dhe informata lidhur me çështjet që duhet të shqyrtohen në Këshill, siç është paraparë në nenin 1.2;

- (b) Përgatit dhe ia paraqet për miratim PSSP-së propozimin e rendit të ditës për mbledhjet e Këshillit, duke përfshirë edhe pikat e propozuara për diskutim nga anëtarët e Këshillit dhe

- (c) Bashkërendon punën me organet e tjera përkatëse të UNMIK-ut dhe të IPVQ-së lidhur me çdo çështje që duhet të shqyrtohet nga Këshilli.

2.3 Ministria për Financa dhe Ekonomi i paraqet drejtpërsëdrejti Këshillit shënime dhe raporte lidhur me të dalat dhe të hyrat e buxhetit të IPVQ-së.

2.4 Pas diskutimit të Këshillit lidhur me çështjet e shqyrtuara, PSSP-ja mund të vendosë për kuptimin e diskutimeve të tilla dhe për çdo konkluzion që mund të nxirret nga ato diskutime.

Neni 3  
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 4  
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 6 maj 2002.

Michael Steiner,  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm